



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5727 Prot.

Roskovec, më 24, 08 2021

VENDIM

NR 71 .DATË 23 .08 .2021

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.88 DATË 02.12.2020 “PËR MIRATIMIN E  
PAKETËS FISKALE PËR VITIN 2021”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 54 gërma f , në mbështetje të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 35, pika 1, gërma c dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr . 11 datë 26.02.2021 “Për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në Bashkinë Roskovec”,Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1.Miratimin e ndryshimit në kreu II, pika 6 të Paketës Fiskale të vitit 2021,si më poshtë:

**Ishte:**

Tarifë për zënie hapësirë publike për qëllime biznesi - 60 lekë/m<sup>2</sup> /muaj.

**Miratohet të bëhet:**

Tarifë për zënie hapësirë publike për qëllime biznesi.

Njësia Administrative	Tarifa lekë/m <sup>2</sup> /muaj
Roskovec	120
Kuman	80
Kurjan	80
Strum	80



Tarifa llogaritet si detyrim mujor i tatimpaguesit. Këshilli Bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e kësaj tarife, si dhe mund të caktojë nivele të ndryshme të kësaj tarife, sipas nivelit të zhvillimit të veprimtarisë së biznesit në zona të ndryshme të qendrës së banuar.

2. Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Policia Bashkiake për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi në bazë të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6.

**KRYETAR**

**Kadri Hyska**

